

VENDIM
Nr.59, datë 29.10.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga:

Fehmi Abdiu,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hilmi Dakli,	Anëtar i “““
Franc Jakova,	Anëtar i “““
Hajredin Fuga,	Anëtar i “““
Alfred Karamuço,	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““

me sekretare Drita Filto, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura më datë 22.7.1998 çështjen nr.36 Akti që i përket:

KËRKUESE: VALERIA BENUSI, e bija e Baltazarit, banuese në Kavajë, Rr.”Kajo Karafili”, e përfaqësuar me prokurë nga Av.Liliana Ruli.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KOÇO GLOZHENI
2. EMILI GLOZHENI, të përfaqësuar nga Av.Dashamir Kore.
3. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, Rajoni nr.3 Tiranë.
4. BASHKIA E TIRANËS, në mungesë.

OBJEKTI: Deklarimin antikushtetues të vendimeve nr.2249, datë 19.5.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; nr.1717, datë 1.8.1998 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr.49, datë 16.1.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

Kërkuesja ka parashtruar së antikushtetutshmëria e këtyre vendimeve konsiston në procesin e parregullt ligjor të vërtetuar gjatë gjykimit të kësaj çështje nga ana e tri gjykatave të përmendura.

Sipas saj ato kanë shkelur nenin 38 të ligjit Kushtetues “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” dhe se këto shkelje janë manifestuar në këto drejtime:

1. Çështja me objekt anulimin e vendimit të Komisionit të Kthimit të Pronave datë 29.08.1998 përbën gjë të gjykuar. Ky konflikt midis meje dhe paditësit Koço Glozheni është zgjidhur më parë me vendime gjyqësore të formës së prerë, të dhëna për një padi tjetër që ka ngritur ky i fundit për anulimin e vendimit të Seksionit të Finances të vitit 1992, i cili me ka kthyer mua pronën objekt padie.

2. Këtë vendim, ky organ i administratës shtetërore e ka dhënë brenda kompetencave të veta, prandaj edhe gjykata e ka ligjëruar drejtësinë e tij duke rrëzuar padinë e parë të paditësit.

Në këto rrethana ajo nuk kishte pse të pranonte padinë e dytë të paditësit dhe t’i jepte të njëjtit konflikt që kishte lindur midis nesh një zgjidhje të kundërt.

3. Në veçanti edhe kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit ka shkelur kërkesat e nenit 38 të ligjit kushtetues “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”. Vendimi i tij i paarsyetuar me të cilin nuk më është pranuar rekursi për shqyrtim, që unë kam ushtruar kundër vendimeve të gjykatave të rrethit dhe të Apelit Tiranë, flet qartë për zhvillimin e një procesi të parregullt ligjor.

Nga ana tjetër, vetë ekzistenca e dy palë vendimeve të formës së prerë që na japin të drejtë si mua ashtu dhe paditësit, ka krijuar një situatë të papërcaktuar, e cila e ka lënë të pazgjidhur konfliktin midis nesh.

GJYKATA KUSHTETUESE ,

pasi degjoi relacionin përkatës, palët dhe avokatet e tyre dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Vendimet gjyqësore të kundërshtuara pranë kësaj Gjykate nga kërkuesja Valeria Benusi, nuk i përgjigjen kërkesave të ligjit kushtetues për “Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut”. Vetë përmbajtja e tyre tregon se zgjidhja e mosmarrëveshjes civile midis saj dhe subjektit të interesuar Koço Glozheni është realizuar pa kaluar nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor, kërkesë kjo e nenit 38

të këtij ligji.

Kjo shkelje me karakter kushtetues është shfaqur fillimisht në procesin e zhvilluar për këtë çështje nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Rajonit nr.3 Tiranë.

Me datë 29.8.1996, ky organ i administratës shtetërore ka vendosur që gjysma e një shtëpie trikateshe të ndodhur në Rrugen “Reshit Petrela” të qytetit të Tiranës, e blerë në vitin 1959 nga i lartëpërmenduri, t’i merret këtij dhe t’i kthehet kërkueses si pasuri, e cila i është konfiskuar me vendim penal babait të saj Baltazar Benusi, ish-i dënuar politik.

Parregullsia e këtij procesi konsiston në dy drejtime:

Së pari, komisioni ka shkelur rregullat mbi juridiksionin, të parashikuara nga neni 36 i Kodit të Procedurës Civile.

Sipas kësaj dispozite, ai, si institucion që nuk bën pjesë në sistemin e organeve gjyqësore, nuk kishte të drejtë ta shqyrtonte këtë mosmarrëveshje civile dhe ta zgjidhte atë me vendim, përderisa në atë kohë kjo ishte duke u gjykuar nga gjykata.

Së dyti, ky veprim i tij vjen në kundërshtim edhe me rregullat për shpërndarjen e kompetencave lëndore midis vetë organeve të administratës shtetërore. Asnjë nga këto rregulla nuk e autorizonte atë të merrte përsëri në shqyrtim këtë çështje, sepse kjo ishte ezauruar vite më parë nga një organ tjetër shtetëror, seksioni i financave pranë Bashkisë së Tiranës. Në vitin 1992, ky me vendim të rregullt, këtë pjesë shtëpie ia ka kthyer kërkueses, motrës dhe vëllezërve të saj, si trashëgimtarë të radhës së parë të ish-të dënuarit politik, Baltazar Benusi.

Në atë kohë, ende nuk kishte dalë ligji “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronareve” dhe nuk ishin krijuar komisionet e posaçme për zbatimin e tij. Vepronin vetëm Ligji nr.7514, date 30.09.1991 “Për pafajsine, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-te denuarve e te perndjekurve politike” si dhe udhezimi nr.16, date 8.8.1992 që kishte nxjerrë në bazë e për zbatim të tij Ministria e Financave.

Në këto akte normative parashikohej që këtyre personave u kthehej pasuria e konfiskuar dhe se kjo detyrë u ngarkohej seksioneve të financave pranë organeve të pushtetit lokal.

Nga ana tjetër, edhe ligji “Për kthimin e pronave” nuk u njeh komisioneve të kthimit të pronave të drejtën për të rishikuar vendimet e seksioneve të financës të dhëna për këtë kategori çështjesh.

Prandaj duke e parë çështjen nga këto këndvështrime, Gjykata çmon se vendimi nr.659, datë 29.8.1996 i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Rajonit nr.3 Tiranë, si produkt i këtij procesi të rregullt ligjor mbetet një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm. Si i tillë ai nuk mund të prodhojë asnjë efekt, pavarësisht se çështjes në shqyrtim i ka dhënë të njëjtën zgjidhje si dhe Seksioni i Financës pranë Bashkisë Tiranë.

Ky proces i parregullt ligjor, por me mangësi në drejtime të tjera, ka shoqëruar edhe gjykimet për zgjidhjen në rrugë gjyqësore të kësaj mosmarrëveshje civile.

Gjykata e Rrethit dhe ajo e Apelit Tiranë, duke pranuar padinë e subjektit të interesuar Koço Glozheni dhe duke e njohur këtë si titullar të shtëpisë objekt gjykimi, i kanë mohuar kërkueses të drejtën e pronësisë mbi këtë pasuri, pa zhvilluar një proces të rregullt ligjor.

Shkelja e kësaj të drejtë kushtetuese që ka përfshirë të tria shkallët e gjykimin, konsiston në mosrespektimin e parimit të njohur procedural, sipas të cilit vendimet gjyqësore të formës së prerë janë të detyrueshme për gjykatën dhe për palët që kanë marrë pjesë në gjyq, se ato nuk mund të rishikohen veçse kur prishen nga një gjykatë më e lartë, ose vërtetohen rastet e rishikimit apo të kundërshtimit të tyre nga të tretët.

Ky parim, parashikohet në mënyrë të shprehur në disa dispozita të Kodit të Procedurës Civile, por nuk ka gjetur zbatim, sepse gjykatave që kanë shqyrtuar këtë padi të subjektit të interesuar, nuk ia ka tërhequr vëmendjen fakti se po këto pretendime, ky ka parashtruar edhe në një padi tjetër që ka ngritur kundër kërkueses.

Këtë padi Gjykata e Rrethit Tiranë e ka rrezuar si të pabazuar dhe vendimi i saj është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit në muajin dhjetor të vitit 1996, duke marrë kështu formë të prerë.

Megjithëse në këtë rast nuk ndodhemi para gjësë së gjykuar, për shkak të disa ndryshimeve që ekzistojnë midis elementeve të këtyre padive, përsëri objekti i tyre në kuptimin material ka qenë i njëjtë: kontestimi i pronësisë së kërkueses nga i lartëpërmenduri mbi shtëpinë e ndodhur në Rrugën “Reshit Petrela” dhe pretendimi i tij se kjo pronë i takon vetëm atij për shkak se shteti që ia ka tjetërsuar, është bërë pronar i kësaj pasurie jo duke ia konfiskuar atë babait të kërkueses si ish-i dënuar

politik, por për llogari të ekzekutimit forcërisht të një detyrimi civil që ky ka pasë ndaj ish -Bankës di Napoli, veprimtarinë e së cilës e ka trashëguar me ligj Banka e Shtetit Shqiptar.

Në fakt, siç u tha edhe më sipër, kjo rrethanë është sqaruar dhe me vendimet e mëparshme, të formës së prerë, të ligjëruara këto dhe nga kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, një pretendim i tillë është rrëzuar si i pabazuar.

Në këto kushte gjykatës nuk i lejohej të shqyrtonte përsëri themelin e kësaj çështje dhe të dilte me një zgjidhje tjetër në kundërshtim me të paren, përderisa në rastin konkret ajo nuk ka pasur për shqyrtim ndonjë kërkesë të veçantë për rishikim vendimi.

Veç sa sipër, në vazhden e këtyre shkeljeve është edhe injorimi ose mosmarrja parasysh në zgjidhjen e çështjes e vendimit nr.13, datë 30.3.1948 të Gjykatës Ushtarake të Grarnizonit Tiranë, i ndryshuar më vonë nga Gjykata e Lartë Ushtarake, i cili përmban dënimin e të ndjerit Baltazar Benusi me 7 (shtatë) vjet burg dhe me konfiskimin e $\frac{1}{2}$ së pasurisë së tij të lujtshme e të palujtshme; e vendimit nr.491, datë 28.08.1948 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të qytetit të Tiranës, për sekuestrimin e kësaj pasurie, ku përfshihet edhe gjysma e shtëpisë objekt konflikti, si edhe e shënimeve të bëra në bazë të këtyre vendimeve në regjistrat e Zyrës së Ipotekave.

Për më tepër, gjykata i është kundërvënë fuqisë së plotë provuese të këtyre akteve, sepse ka pranuar fakte që nuk pajtohen me përmbajtjen e tyre, pa u pretenduar dhe goditur ata për falsitet, ashtu siç parashikohet në nenin 254 të Kodit të Procedurës Penale.

Të gjitha këto shkelje janë reflektuar edhe në gjykimet që kanë zhvilluar për këtë çështje Gjykata e Apelit Tiranë dhe kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit. Ndaj këtyre shkeljeve këta të fundit, jo vetëm nuk kanë reaguar, por i kanë përligjur ato duke e lënë të paprekur, gjykata më e lartë vendimin e gjykatës më të ulët.

Nga ana tjetër, kolegji civil i Gjykatës së Kasacionit, duke mos pranuar asnjërin prej rekurseve të ushtruara nga palët ndërgjyqëse e ka lënë të pazgjidhur konfliktin midis tyre.

Si rezultat i kësaj, vazhdojnë të jenë në fuqi vendime të gjykatës së rrethit dhe të Apelit që kundërshtojnë njëri-tjetrit. Është krijuar kështu një situatë juridike e papërcaktuar, sepse si kërkuueses ashtu edhe subjektit të interesuar Koço Glozhenit u është njohur pronësia ekskluzive mbi shtëpinë, objekt kjo, në kuptimin material, i të dy padive që ka ngritur ky i fundit.

Prania e kësaj rrethane, krahas shkeljeve të tjera të vërtetuara në gjykimet e shkallës së parë e të dytë dhe pajtimi me këto shkelje i Gjykatës së Kasacionit, nxjerr në pah edhe një herë parregullsitë që kanë përshkuar gjithë këtë proces gjyqësor të përfunduar me vendimet, objekt i kësaj kërkesë.

PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në bazë të nenit 38 të ligjit nr.8373, datë 15.07.1998 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, njëzëri,

VENDOSI:

Të deklarojë antikushtetues vendimin nr.2249, datë 19.05.1997 të Gjykatës së Rrethit Tiranë; vendimin nr.1717, datë 01.08.1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimin nr.49, datë 16.1.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.